



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

---

Nr. 453 Prot.

Tiranë, më 11. 03. 2020

**V E N D I M**

**Nr. 30, Datë 11/03/2020**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 121, datë 26.09.2019, e znj. A.C., ku pretendohet për diskriminim për shkak të “*bindjes politike*”<sup>1</sup>, nga ana e Kryetarit të Bashkisë Gjirokastrë.

Pas shqyrtimit përfundimtar të ankesës së mësipërme, Komisioneri<sup>2</sup>,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas ankuesve.**

Mbështetur në informacionin që përmban formulari i ankesës, si dhe referuar dokumentacionit bashkëlidhur, rezulton se Znj. A.C. ka punuar në pozicionin Drejtorë në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse, në Bashkinë Gjirokastrë që prej datës 21.10.2016. Ankuesja pretendon se pas zgjedhjeve lokale të vitit 2019, me ardhjen në detyrë të kryetarit të ri të Bashkisë Gjirokastrë, i cili është përfaqësues i forcës politike “*Partia Socialiste*”, ajo u ekspozua ndaj një trajtimi diskriminues për shkak të bindjes politike. Masat që ankuesja ka kërkuar nga Komisioneri janë: konstatim diskriminimi për largimin nga puna, si dhe rikthim në vendin e punës.

Znj. A.C. pretendon se në datën 05.08.2019, gjatë një takimi me Kryetarin e Bashkisë Gjirokastrë, ky i fundit i ka komunikuar verbalisht, se ajo do të ndërrojë vendin e punës me specialistin e Burimeve Njerëzore dhe njëkohësisht e ka detyruar të marrë lejen vjetore për vitin 2019. Në vijim të takimit, ankuesja shprehet se i është dorëzuar urdhëri i kryetarit për fillimin e lejes vjetore në datën 06.08.2019.

---

<sup>1</sup> Referuar kartës së anëtarësisë nr. 17235, datë 31.08.2016, të lëshuar nga subjekti politik “*Lëvizja Socialiste për Integritim*”, rezulton se ankuesja është anëtare e kësaj force politike.

<sup>2</sup> Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën KMD.

Në datën 06.08.2019, ankuesja pretendon se është larguar për pushime drejt Sarandës, ndërkohë që Drejtori i Kabinetit të Bashkisë Gjirokastër e ka marrë në telefon, ku i kërkon çelësin e zyrës së saj. Në vijim, Znj. A.C. shprehet se është vënë në dijeni të faktit se zyra e saj është hapur me forcë, me justifikimin se kryetari i duhet një dosje, që administrohej nga Znj. A.C.. Ajo shprehet se nga zyra e saj ishin tërhequr edhe dosje e dokumente të tjera, të cilat ajo i kishte në ngarkim.

Përveç sa më sipër, Znj. A.C. shprehet se gjatë periudhës, që ajo ishte me leje vjetore, Kryetari i Bashkisë ka miratuar Urdhërin nr. 36, datë 30.08.2019 “Për krijimin e Komisionit Disiplinor për pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil në Bashkinë Gjirokastër”. Komisioni Disiplinor, i ngritur nëpërmjet këtij urdhëri, ka vendosur pezullimin e ankueses nga detyra me Vendimin e tij nr. 37, datë 02.09.2019.

Pas paraqitjes në punë, ankuesja pretendon se ka regjistruar në zyrën e protokollit një Akt-Konstatimi, lidhur me faktin se zyra, ku ajo punonte ishte hapur me forcë, si dhe ka kryer kallëzim pranë organeve të rendit publik.

Për sa më sipër, ankuesja A.C. pretendon se diskriminohet për shkak të bindjes politike nga ana e Kryetarit të Bashkisë Gjirokastër.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

- A.** Pas analizimit të ankesës nr. 121, datë 26.09.2019, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.
- B.** Mbështetur në nenin 33, pika 7<sup>3</sup>, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua me shkresën nr. 1463/1, datë 03.10.2019, Kryetarit të Bashkisë Gjirokastër dhe për dijeni ankueses, ku kërkohej informacioni, si më poshtë vijon:
  - Kërkesa e Znj. A.C. drejtuar eprorit të saj, për lejen vjetore të vitit 2019;
  - Akti administrativ i Kryetarit të Bashkisë Gjirokastër drejtuar ankueses mbi fillimin e lejes vjetore 2019;
  - Listëprezenca e punonjësve të Bashkisë Gjirokastër/Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse, për muajt gusht-shtator 2019;
  - Akti administrativ për ngritjen e Komisionit Disiplinor.

---

<sup>3</sup> Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon: “Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër”.

- Të gjitha aktet administrative të nxjerra nga Komisioni Disiplinor, lidhur me ankuesen A.C..
- Vlerësimet ne punë për Znj. A.C.;
- Informacion nëse ankuesja ka në ngarkim masa disiplinore, që nga viti 2016 e në vijim;
- Kopje e librezës së punës së ankueses.

1. Në përgjigje të shkresës nr. 1463/1, datë 03.10.2019, të KMD-së, Kryetari i Bashkisë Gjirokastrë dërgoi shkresën nr. 1463/2, datë 24.10.2019, nëpërmjet së cilës informon se znj. A.C. ka marrë lejen vjetore të pagueshme për vitin 2019, pasi ka diskutuar dhe ka rënë dakord paraprakisht me kryetarin e Bashkisë Gjirokastrë. Largimi i nëpunëses civile znj. A.C. me leje vjetore, pavarësisht se administronte dokumentacionin e personelit dhe të burimeve njerëzore, jo në përputhje me ligjin, nuk është shoqëruar me dorëzimin e këtij dokumentacioni, për të siguruar mbarëvajtjen e punës, në mungesë të saj. Në këto kushte, është funksionuar me marrjen e masave konkrete me qëllim sigurimin e mbarëvajtjes në punë, në mungesë të saj, në këtë sektor. Në shkresë theksohet fakti se ankuesja nuk ka patur në ngarkim masa disiplinore nga viti 2016, deri në datën 17.10.2019. Bashkëlidhur shkresës në fjalë, Bashkia Gjirokastrë ka dërguar aktet e mëposhtëme:

- Urdhër nr. 267, datë 05.08.2019, për caktimin e fillimit të datës së fillimit të pushimeve vjetore për znj. A.C.;
- Listëprezenca e punonjësve të Bashkisë Gjirokastrë, për periudhën kohore gusht-shtator 2019; Vendimi nr. 36, datë 30.08.2019, për krijimin e komisionit disiplinor për pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil në Bashkinë Gjirokastrë;
- Shkresa nr. 6313 prot., datë 30.08.2019, rekomandim për fillim mase disiplinore për nëpunësen civile A.C., së bashku me dokumentacionin bashkëlidhur;
- Vendimi nr. 37, datë 02.09.2019, për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pezullimin nga shërbimi civil i Komisionit Disiplinor;
- Proçesverbal i datës 18.10.2019, i mbajtur nga Komisioni Disiplinor;
- Formular i vlerësimit të punës për nëpunësit civil të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesëm drejtues për periudhën kohore 21.05.2016 – 30.06.2016.
- Formular i vlerësimit të punës për nëpunësit civil të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesëm drejtues për periudhën kohore 01.07.2016 – 31.11.2016.
- Formular i vlerësimit të punës për nëpunësit civil të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesëm drejtues për periudhën kohore 15.12.2016 – 15.06.2017.
- Formular i vlerësimit të punës për nëpunësit civil të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesëm drejtues për periudhën kohore korrik – dhjetor 2017;
- Kopje e librezës së punës së znj. A.C..

2. Në vijim të ndjekjes së proçedurave të shqyrtimit administrativ, palët u njoftuan për seancë dëgjimore, e cila u vendos të realizohet në datën 18.12.2019, ora 12:00, pranë Zyrës së KMD-së.

Në seancë dëgjimore mori pjesë vetëm ankuesja. Kryetari i Bashkisë Gjirokastrë nuk u përfaqësua dhe si rrjedhim seanca u zhvillua në mungesë të subjektit kundër së cilit drejtohet ankesa.

Ankuesja A.C. parashtrori pretendimet e saj, që konsistojnë në diskriminim për shkak të bindjes politike. Ajo u shpreh se është anëtare e subjektit politik Lëvizja Socialiste për Integrim dhe ka punuar për 3 vjet pranë Bashkisë Gjirokastrë. Pozicioni i fundit i punës që ajo ka mbajtur ka qenë Drejtore e Burimeve Njerëzore. Marrëdhëniet e punës për këtë pozicion pune rregulloheshin ligjërisht nga legjislacioni mbi nëpunësin civil. Ajo u shpreh se diskriminimi i saj i kishte filluar me emërimin e kryetarit të ri të Bashkisë Gjirokastrë Flamur Golemi. Pas emërimit të tij në detyrë ai shoqërohej në ambientet e Bashkisë, nga disa persona që e ndihmonin në kryerjen e detyrave të tij, e në vijim u emëruan në pozicione drejtuese të këtij institucioni. Ankuesja pretendon se në vijim të marrjes së detyrës nga z. Golemi, asaj nuk i kaloheshim më shkresa, si dhe nuk u lejua të kryente punën e përditshme. Në një takim të patur me titullarin e ri të institucioni, në datën 05.08.2019, ky i fundit është shprehur se, ajo do të duhej të zëvendësohej nga dikush tjetër, si dhe në vijim i ka kërkuar të marrë lejen vjetore. Ankuesja e ka refuzuar të marrë lejen vjetore, pasi e kishte parashikuar ta merrte gjatë një periudhe tjetër kohore. Por, pavarësisht kësaj, në krye të disa orëve, brenda së njëjtës dite, është akti i Kryetarit të Bashkisë Gjirokastrë sipas së cilit ajo duhet të fillonte lejen vjetore të vitit 2019 në datën 06.08.2019. Ajo thekson faktin se leja i është dhënë në mënyrë të imponuar, pa ndonjë kërkesë paraprake të depozituar nga ana e saj. Znj. A.C. shprehet se ka shkuar për të kundërshtuar verbalisht urdhërin e mësipërm, por kryetari i Bashkisë nuk e ka pritur në takim. E pyetur se cili ishte procesi për dhënien e lejes vjetore, ankuesja u shpreh se lejet miratoheshin me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë, parashikoheshin në formë grafiku dhe komunikoheshin me e-mail. Znj. A.C. u shpreh se më parë, ajo e merrte lejen vjetore, njëkohësisht me Kryetarin e Bashkisë, në mënyrë që të mos pengohej ecuria e punës.

Ditën vijuese, ankuesja sqaron se është nisur për në Sarandë. Ajo pretendon se të nesërmen është marrë në telefon nga shefi i kabinetit të Kryetarit të Bashkisë Gjirokastrë, i cili i ka kërkuar çelësin e zyrës së saj. Ajo shprehet se nuk mund t'ia jepte çelësin e zyrës së saj, pasi aty kishte shumë dokumente, të cilat i kishte në ngarkim. Në mungesë të çelësit, dera e zyrës së saj ishte hapur forcërisht dhe ishte marrë në dorëzim nga disa punonjës. Ndërkohë që, Kryetari kishte nxjerrë Urdhërin nr. 36, datë 30.08.2019, nëpërmjet së cilit urdhëronte krijimin e Komisionit Disiplinor. Me Vendimin nr. 37, datë 02.09.2019, të Komisionit Disiplinor, *“Për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pezullimin nga shërbimi civil”* është vendosur fillimi i procedimit disiplinor ndaj saj, për shkak së veprimet dhe mosveprimet e ankueses, kanë sjellë pasoja të rënda. Nëpërmjet vendimit të mësipërm është vendosur gjithashtu pezullimi nga detyra për znj. A.C., deri në momentin e marrjes së një vendimi përfundimtar. Kjo, për shkak se mund të pengohej procedimi administrativ, si dhe mund të cënohej vazhdimi normal i funksioneve të njësisë së burimeve njerëzore. Pas përfundimit të lejes vjetore, ankuesja sqaron se është rikthyer në punë dhe ka marrë dijeni mbi urdhërin dhe vendimin e sipërpërmendur, të cilët ishin miratuar gjatë periudhës kohore, që ajo ishte me leje. Ndërkohë që, brava e zyrës së saj ishte ndërruar dhe ajo nuk kishte çelës për të patur akses në të.

Znj. A.C. u shpreh se ka depozituar kallëzim penal në Prokurorinë e rrethit gjyqësor Gjirokastrë lidhur me hapjen forcërisht të derës së zyrës së saj gjatë kohës, që ajo ishte me leje vjetore. Ankuesja pretendon se prokuroria ka vendosur mosfillimin e procedimit penal. Ankuesja e ka ankimuar

gjyqësisht vendimin e prokurorisë së rrethit gjyqësor Gjirokastrë. Çështja është kaluar për gjykim pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastrë, e cila është shprehur me Vendimin nr. 111[21-2019-1988], datë 29.10.2019, nëpërmjet së cilit është vendosur prishja e vendimit të mosfillimit të procedimit penal, më datë 10.09.2019, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, si dhe është urdhëruar prokuroria të regjistrojë procedimin penal dhe të kryejë hetimet, që do të përcaktohen në vendimin gjyqësor.

Për sa më sipër, përfaqësuesit e KMD-së e bënë më dije ankuesen se lidhur me çështjen e hapjes forcërisht të derës së zyrës, Komisioneri nuk mund të shprehet për sa kohë është duke u proceduar penalisht nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë. Znj. A.C. iu kërkua që nëse organi i prokurorisë do të shprehej me vendim mbi çështjen nën hetim, ajo të njoftonte KMD-në dhe të përcillte një kopje të vendimit përkatës.

E pyetur se si e vërteton faktin se ajo është larguar nga puna për shkak të bindjes politike, ankuesja shprehet se ajo ka patur takime joformale me kryetarin e Bashkisë Gjirokastrë, i cili ia ka shprehur vetë, në mënyrë të drejtpërdrejtë një fakt të tillë.

3. Me e-mailin e datës 26.12.2019, ankuesja A.C. dërgoi pranë Komisionerit informacionin mbi drejtorë të tjerë të Bashkisë Gjirokastrë, të cilët janë larguar nga puna, për shkak të bindjes politike. Ajo sqaron se z. A. M., i cili mbante pozicionin e Drejtor i Agjencisë së Shërbimeve Bujqësore, Veterinare dhe Mjedisore është larguar gjithashtu nga puna. Ai gëzonte statusin e nëpunësit civil dhe është larguar nga puna për arsye politike, pasi është anëtar i forcës politike LSI. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë e ka gjetur të padrejtë largimin e tij nga puna. Njëkohësisht, edhe z. A. M., i cili mbante pozicionin Drejtor i Agjencisë së Mirëqënies Sociale është larguar nga puna, pasi është anëtar i LSI- së. Marrëdhëniet e punës së z. A.M. rregulloheshin nga dispozitat e Kodit të Punës. Edhe ky i fundit e ka ankimuar gjyqësisht çështjen e largimit nga puna.
4. Në vijim të seancës dëgjimore, dhe e-mailit të dërguar nga ankuesja, Komisioneri dërgoi pranë Bashkisë Gjirokastrë, shkresën nr. 213, datë 03.02.2020, nëpërmjet së cilës kërkohet informacioni i mëposhtëm:
  - Informacion mbi numrin e punonjësve të larguar nga puna pranë Bashkisë Gjirokastrë, përgjatë periudhës kohore qershor – dhjetor 2019. Informacioni të konsistojë në të dhënat dhe dokumentacionin e mëposhtëm:
    - Lista e emrave të punonjësve të Bashkisë Gjirokastrë, (përfshirë edhe institucionet e varësisë), të cilët janë larguar nga puna. Në këtë listë, të reflektohet pozicioni që kanë mbajtur këta punonjës, data e saktë e emërimit dhe lirimit nga detyra dhe motivacioni i largimit;
    - Kopje të urdhërave për zgjidhje të kontratës së punës, për secilin prej tyre;
    - Informacion, sa prej tyre e kanë ankimuar gjyqësisht zgjidhjen e kontratës së punës dhe cila është vendimmarrja e gjykatës kompetente;

- Numri i punonjësve të Bashkisë Gjirokastrë, që janë larguar me doreheqje, brenda së njëjtës periudhë kohore;
- Informacion mbi punonjësin, që ka zëvendësuar znj. A.C., në pozicionin Drejtorë në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse, pranë Bashkisë Gjirokastrë. Kopje e dosjes së tij/saj personale;

Bashkëlidhur shkresës së sipërpërmendur, Komisioneri dërgoi edhe një kopje të procesverbalit të seancës dëgjimore, të datës 18.12.2019.

5. Bashkia Gjirokastrë dërgoi informacionin e kërkuar nga KMD, nëpërmjet shkresës nr. 1021/1, datë 10.02.2020.

### **III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës nr. 121, datë 26.09.2019, së Znj. A.C., Komisioneri jep vlerësimin dhe gjykimin e tij, vetëm për ato çështje, të cilat bëjnë pjesë në kompetencat, që këtij institucioni, i atribuohen nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”.

#### **A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë.**

Në ankesën nr. 121, datë 26.09.2019, e Znj. A.C., ku pretendohet për diskriminim për shkak të “*bindjes politike*”, nga ana e Kryetarit të Bashkisë Gjirokastrë.

Mbështetur në provat e administruara gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës së sipërpërmendur rezulton se, nëpërmjet Urdhërit nr. 525/1, datë 01.11.2016, të Kryetarit të Bashkisë Gjirokastrë, znj. A.C. është emëruar në pozicionin e Drejtorit në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse, pranë Bashkisë Gjirokastrë.

Në kushtet kur, në zgjedhjet vendore të vitit 2018, fituese rezultoi subjekti politik “*Partia Socialiste e Shqipërisë*”, e cila nuk ishte me në koalicion me subjektin politik Lëvizja Socialiste për Integrim, Kryetari i ri, i Bashkisë Gjirokastrë u zgjodh z. F. G., anëtar dhe përfaqësues i subjektit politik Partia Socialiste e Shqipërisë.

Me ardhjen në detyrë, në qershor 2018, të Kryetarit të ri të Bashkisë Gjirokastrë, z. F. G., ankuesja pretendon se ndaj saj ka filluar diskriminimi, për shkak të bindjes politike. Për sa më sipër, në një takim informal që ka patur me z. F. G., në datën 5 gusht 2019, asaj i është komunikuar verbalisht fakti se do të lëvizë nga pozicioni i punës, fakt të cilin znj. A.C. e ka kundërshtuar. Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se një fakt i tillë është i paprovueshëm, pasi mbetet në kuadër të pretendimeve verbale të pambështetura në prova konkrete.

Ankuesja pretendon se në vijim të takimit të sipërpërmendur, Kryetari i Bashkisë Gjirokastrë i ka dhënë pa dëshirën e saj lejen vjetore 28 ditore, për vitin 2019, e cila fillonte në datën 06.08.2019.

Për sa më sipër, në kushtet kur, marrëdhëniet e punës për pozicionin e Drejtorit të Shërbimeve Mbështetëse, pranë Bashkisë Gjirokastrë, rregullohen nga legjislacioni mbi shërbimin civil, dhënia e lejes vjetore për nëpunësin civil përkatës rregullohet nëpërmjet Vendimit nr. 511, datë 24.10.2002, të Këshillit të Ministrave, “Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore”, (i ndryshuar). Në pikën 2, të Kreut II, të këtij Vendimi parashikohet: “Kohëzgjatja e pushimit vjetor të paguar është 4 jave kalendarike. Koha e kryerjes së lejes së pushimit vjetor përcaktohet nga drejtuesi i institucionit, sipas kërkesës së nëpunësit civil apo të punonjësit, duke mos cënuar vijueshmërinë e punës.....”

Në këtë kontekst, Komisioneri i kërkoi zyrtarisht Bashkisë Gjirokastrë të dërgojë në cilësi prove kërkesën e ankueses, nëpërmjet së cilës kërkohet leja vjetore për vitin 2019. Në shkresën zyrtare të këtij institucioni drejtuar KMD-së nuk u depozitua një provë e tillë.

Ndërkohë që, ankuesja depozitoi pranë KMD-së, në cilësi prove Urdhërin nr. 241, datë 29.07.2019, e ish-Kryetares së Bashkisë Gjirokastrë, “Për dhënie leje pushimi vjetor”, ku rezultojnë datat e lejes vjetore, për të gjithë punonjësit e Bashkisë Gjirokastrë. Në këtë Urdhër rezulton se ankuesja A.C. ka kërkuar të merrte lejen vjetore përgjatë periudhës 14 – 25.10.2019. Në këtë kontekst, në mungesë të një kërkesë të ankueses nëpërmjet së cilës kërkohet leja vjetore 2019, si dhe në kushtet kur ekziston paraprakisht një akt i ish-Kryetares së Bashkisë, që vendos për datat e lejeve vjetore të punonjësve të kësaj Bashkie, akt i cili nuk është shfuqizuar nga Kryetari aktual, Komisioneri gjykon se z. F.G., Kryetar i Bashkisë Gjirokastrë nuk ka zbatuar legjislacionin në fuqi për dhënien e lejes vjetore për znj. A.C..

Në vijim të largimit të znj. A.C. me leje vjetore, me Urdhërin nr. 283, datë 08.08.2019, e Kryetarit të Bashkisë Gjirokastrë, “Për vendosjen në dispozicion të praktikës së punonjësit” është kërkuar nga specialistja e burimeve njerëzore të këtij institucioni, që të vërë në dispozicion dosjen e personelit në lidhje me z. K.K. me detyrë Sekretar i Përgjithshëm i Bashkisë Gjirokastrë, si dhe të gjithë praktikën dokumentare, në lidhje me shpalljen e vendeve të lira të punës në kategorinë ekzekutive për jurist dhe audit në Bashkinë Gjirokastrë.

Me shkresën nr. 578 prot., datë 08.08.2019, drejtuar Kryetarit të Bashkisë Gjirokastrë, specialistja e Burimeve Njerëzore ka informuar se zbatimi i Urdhërit të tij, të sipërpërmendur, është i pamundur, pasi ajo nuk disponon çelësat e ambienteve, ku mbahet dokumentacioni i kërkuar, si dhe ky dokumentacion nuk i është dhënë asnjëherë asaj në administrim.

Në këto kushte, në datën 08.08.2019, Drejtori i Kabinetit të Kryetarit të Bashkisë Gjirokastrë e ka njoftuar ankuesen me telefon, për të dorëzuar çelësin e zyrës, por ajo ka refuzuar, pasi pretendon se dokumentacioni i zyrës ka qenë në ngarkim të saj. Në mungesë të çelësit, zyra e saj është hapur me forcë, si dhe është mbajtur Proçesverbali përkatës i datës 09.08.2019, ora 15.40, në prani të Komisionit të ngritur, me Urdhërin nr. 290, datë 09.08.2019, e Kryetarit të Bashkisë Gjirokastrë, për hapjen e Zyrës së Burimeve Njerëzore. Referuar këtij proçesverbali rezulton se pas hapjes së derës, janë bërë fotokopje të akteve të dosjes së z. K.K. e cila u vendos përsëri në vendin e mëparshëm. Në proçesverbal gjithashtu citohet: “Në vijim në prani të Komisionit u

*ndërrua brava nga punonjësit e Agjencisë së Shërbimeve Publike të lartpërmendur, të cilët qenë ngarkuar me këtë detyrë. U mbyll dera dhe çelësat në 3 kopje iu dorëzuar punonjësit të policisë z. E. Sh., në prani të kryetarit.”*

Në vijim, nëpërmjet Urdhërit nr. 284, datë 08.08.2019, të Kryetarit të Bashkisë është urdhëruar të bëhet inventarizimi i të gjithë dokumentacionit të personelit (dosjet përkatëse) praktikave dokumentare, në lidhje me shpalljen e vendeve të lira të punës dhe çdo praktikë tjetër në proces, që ndodhej në zyrën e burimeve njerëzore. Nëpërmjet Urdhërit të mësipërm është urdhëruar që dokumentacioni i inventarizuar t'i dorëzohet specialistes së Drejtorisë së Burimeve Njerëzore. Referuar procesverbalit të mbajtur në datën 13.08.2019, ora 9:00, Komisioni përkatës ka kryer inventarizimin e objekteve dhe dokumentacionit të kësaj zyre.

Mbështetur në dokumentacionin e administruar në cilësi prove rezulton se në vijim, pas kthimit nga leja vjetore, ankuesja ka depozituar kallëzim penal kundër Kryetarit të Bashkisë Gjirokastrë, lidhur me çështjen e hapjes forcërisht të derës së zyrës së saj. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë ka vendosur për mosfillimin e procedimit penal. Pas kundërshtimit të këtij vendimi të prokurorisë, nga ana e ankuses, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastrë, kjo e fundit është shprehur me Vendimin nr. 111 [21-2019-1988], datë 29.10.2019, nëpërmjet së cilit detyron Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë të regjistrojë procedimin penal dhe të kryejë hetimet, që do të përcaktohen në vendimin gjyqësor. Në kushtet kur, kjo çështje është nën hetim penal, e në vijim do të jetë në shqyrtim gjyqësor, Komisioneri nuk mund të shprehet lidhur me të.

Gjatë periudhës që ankuesja ka qenë me leje vjetore, Kryetari i Bashkisë Gjirokastrë ka nxjerrë Urdhërin nr. 36, datë 30.08.2019, nëpërmjet së cilit urdhëronte krijimin e Komisionit Disiplinor. Mbështetur në nenin 59, pika 2, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”* (i ndryshuar) Komisioni Disiplinor ka në kompetencën e tij, marrjen e masave disiplinore të parashikuara në shkronjat “b”, “c” dhe “ç” të nenit 58 të këtij ligji, të cilat janë (1) mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj, (2) pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet, (3) largim nga shërbimi civil.

Njëkohësisht, mbështetur në nenin 4, gërma a), të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”* (i ndryshuar), ku parashikohet: *“4. Komisioni disiplinor fillon procedimin: a) me kërkesë të eprorit direkt të nëpunësit civil....”*, nëpërmjet shkresës nr. 6313 Prot., datë 30.08.2019, Kryetari i Bashkisë Gjirokastrë i ka bërë kërkesë Komisionit Disiplinor për fillimin e procedimit disiplinor për znj. A.C., ku dhe ka rekomanduar masën disiplinore *“largim nga shërbimi civil”*, si dhe *“pezullim”* të saj, përgjatë periudhës që do të kryhet hetimi përkatës nga ky Komision. Në kushtet kur, neni 59, pika 7, i ligjit të sipërpërmendur parashikon shprehimisht: *“Procedimi administrativ disiplinor garanton të drejtën e nëpunësit për t’u njoftuar lidhur me fillimin e procedimit, për t’u informuar lidhur me shkeljen faktike të pretenduar dhe provat për kryerjen e saj, të drejtën për t’u dëgjuar, për të paraqitur prova, për mbrojtje juridike dhe të drejtën për t’u asistuar, si dhe të drejtën për t’u ankuar ndaj vendimit përfundimtar”*, shkresa e sipërpërmendur i është dërguar për dijëni edhe znj. A.C., e cila është njoftuar për fillimin e procedimit disiplinor.



Në këtë shkresë citohet shprehimisht: *“Bashkia Gjirokastrë në funksion të përmbushjes së misionit të saj, është duke analizuar situatën e personelit dhe strukturës organizative. Me këtë rast me urdhërat Nr. 283, Nr. 588 Prot dhe nr. 284, Nr. 5782 Prot datë 08.08.2019, është kërkuar administrimi i dokumentacionit përkatës për Sekretarin e Përgjithshëm të Bashkisë Gjirokastrë, gjithë praktika dokumentare, në lidhje me shpalljen e vendeve të lira të punës në kategorinë ekzekutive për jurist dhe audit, si dhe dokumentacioni i administruar në lidhje me burimet njerëzore sipas strukturës përkatëse. Nga informacioni Nr. 5781 Prot, datë 08.08.2019, dërguar nga punonjësit e Zyrës së Burimeve Njerëzore rezultoi se Drejtoresha e Burimeve Njerëzore, znj. A.C. është larguar me leje vjetore të pagueshme dhe nuk ka krijuar mundësinë për administrimin e dokumentacionit të personelit sipas nevojave të përditëshme të punës. Në këto kushte, në funksion të vijimit të veprimtarisë normale të punës, me urdhërin nr. 290, Nr. 5819 Prot, datë 09.08.2019, është urdhëruar hapja e derës së ambienteve, ku ndodhet dokumentacioni i burimeve njerëzore, në mënyrë të përshtatshme, në kushtet e mungesës së çelësave dhe është mbajtur një procesverbal i veçantë në lidhje me konstatimin e gjendjes së dokumentacionit në momentin e hapjes. Gjithashtu çelësi i ambienteve nuk i është dorëzuar nëpunësit të nivelit zbatues (specialist) përgjegjës për burimet njerëzore. Pra situata e përshkruar si më sipër ka krijuar pengesa serioze në lidhje me administrimin përdorimin dhe ruajtjen e dokumentacionit zyrtar në këtë fond arkivor, në funksion të përmbushjes së detyrimit ligjor për realizimin e shërbimeve në fushën e funksioneve në vetëqeverisjen vendore.”*

Në shkresën e sipërpërmendur, sqarohet gjithashtu se nga verifikimi i të dhënave në lidhje me vendbanimin e punonjësve A.K. dhe A.C., me detyrë administratorë të njësive administrative, përkatësisht në Lunxhëri dhe Cepo, rezultoi se këta dy punonjës nuk janë banorë të njësive administrative që drejtojnë. Në këtë mënyrë nuk është bërë verifikimi i vendbanimit të tyre, si detyrim i nenit 65, pika 2, të ligjit nr. 139/2015, *“Për vetëqeverisjen vendore”*. Njëkohësisht në shkresën e Kryetarit të Bashkisë vihet theksi edhe tek disa shkelje ligjore, në lidhje me punësimin e individëve pa arsimin përkatës, si dhe mos marrjen e masave ligjore për ish-Sekretarin e Përgjithshëm, të Bashkisë Gjirokastrë, z. K.K., i cili është kryetar i LSI, dega Gjirokastrë. Emërimi i tij në një pozicion të lartë në shërbimin civil është shkelje e nenit 37, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, (i ndryshuar).

Për sa më sipër, Komisioneri konstaton se në kushtet kur, qëllimi i Kryetarit të Bashkisë Gjirokastrë ishte hetimi mbi dosjet e personelit, të administruara nga Drejtoresha e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, dhënia e lejes vjetore për ankuesen A.C., ka qenë e qëllimshme, për ta mbajtur atë larg këtij procesi. Komisioneri gjykon gjithashtu se nuk është e drejtë, që procedimi disiplinor ndaj një punonjësi të fillojë gjatë periudhës kohore, që ai është duke kryer lejen vjetore.

Në vijim, me Vendimin nr. 37, datë 02.09.2019, e Komisionit Disiplinor, të Bashkisë Gjirokastrë, është vendosur si vijon: *“1. Fillimi i procedimit disiplinor ndaj nëpunëses civile znj. A.C., me detyrë Drejtor i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Bashkinë Gjirokastrë, për largimin nga Shërbimi Civil, për shkak se veprimet dhe mosveprimet e saj kanë sjellë pasoja të rënda. 2.*

*Pezullimin<sup>4</sup> nga kjo detyrë të nëpunëses civile, deri në marrjen e vendimit përfundimtar, për shkak se mund të pengohet procedimi administrativ, si dhe mund të cënohet vazhdimi normal i funksioneve të njësisë së burimeve njerëzore. 3. Nëpunësja civile znj. A.C., me detyrë Drejtor i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Bashkinë Gjirokastrë, do të dëgjohet nga Komisioni në datën 05.09.2019<sup>5</sup>, ditën e enjte ora 12:00.”*

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se masa disiplinore ndaj znj. A.C. ka qenë paraprakisht e vendosur, pasi edhe vetë Komisioni Disiplinor në vendimin e sipërpërmendur ka filluar procedimin disiplinor ndaj saj, për dhënien e një mase të caktuar, përkatësisht atë të largimit nga shërbimi civil. Në interpretim të dispozitave përkatëse të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar) Komisioni Disiplinor duhet të shqyrtojë fillimisht shkeljet, që ka kryer punonjësi civil dhe në vijim duhet të përcaktojë masën disiplinore, sipas nivelit të shkeljeve të konstatuara.

Me Vendimin nr. 52, datë 18.10.2019, Komisioni Disiplinor i Bashkisë Gjirokastrë, ka konstatuar një sërë shkeljesh, të kryera nga znj. A.C., si më poshtë vijnë:

*“Nëpunësja A.C. është njohur me të gjithë dokumentacionin në të cilin përmbahen të dhënat dhe provat, që faktojnë shkeljet e kryera prej saj dhe që në mënyrë të përmbledhur vijnë si më poshtë:*

- 1. Nga informacioni Nr. 5781 Prot, datë 08.08.2019, dërguar nga punonjësjë e burimeve njerëzore, në zbatim të urdhërave Nr. 283, Nr. 578Prot dhe Nr. 284, Nr. 5782Prot, datë 08.08.2019, rezulton se znj. A.C. me detyrë Drejtoreshë e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse është larguar me leje vjetore dhe nuk ka krijuar mundësinë për administrimin e dokumentacionit të personelit. Në funksion të vijimit të veprimtarisë normale të punës me Urdhërin nr. 290, Nr. 5819 Prot, datë 09.08.2019, është urdhëruar hapja e derës së ambienteve, ku ndodhet dokumentacioni i burimeve njerëzore. Situata në fjalë ka krijuar pengesa serioze në lidhje me administrimin përdorimin dhe ruajtjen e dokumentacionit zyrtar në këtë fond arkivor, në funksion të vetëqeverisjes vendore.*
- 2. Nëpunësja civile znj. A.C. nuk ka kryer në vazhdimësi verifikimin e vendbanimit të punonjësjë A.K. dhe A.C. me detyrë administrator të njësjë administrative, përkatësisht Lunxhëri dhe Cepo, si detyrim i ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 65, pika 2, në një kohë që këta punonjës nuk janë banorë të njësjë përkatëse administrative.*

---

<sup>4</sup> Pezullimi i znj. A.C. është mbështetur në parashikimin e nenit 59, pika 6, e ligjit nr. 152/2013, ku citohet shprehimisht: “Nëse ka arsye të besohet se vazhdimi i ushtrimit të detyrës nga nëpunësi civil, ndaj të cilit ka filluar një procedim disiplinor, pengon hetimin administrativ apo mund të cënojë ushtrimin e përshtatshëm të detyrës së tij, komisioni disiplinor mund të vendosë pezullimin e nëpunësit civil ose të marrë çdo masë tjetër të përshtatshme, deri në marrjen e vendimit përfundimtar.”

<sup>5</sup> Me shkresën nr. 6511 prot., datë 06.09.2019, e Kryetarit të Bashkisë është vendosur që data e dëgjimit të shtyhet për në datën 23.09.2019. Shtyrja e datës së takimit dëgjimor është kryer pasi ankuesja ka marrë dijeni për këtë takim në datën 06.09.2019 dhe koha në dispozicion të saj për të përgatitur mbrojtjen e saj juridike ka qenë tepër e shkurtër.

3. *Nëpunësia civile znj. A.C., nuk ka marrë masa konkrete për të mënjanuar parregullsitë në emërimin në detyrën e specialistit pranë Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit , në Bashkinë Gjirokastrë, punonjësit E. G., pasi ky i fundit nuk zotëron arsimin përkatës për këtë pozicion pune të përcaktuar qartësisht nga ligji nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, Neni 11.*
4. *Nëpunësia civile znj. A.C. nuk ka përmbushur detyrimin ligjor për të ndërmarrë veprime konkrete, me qëllim mënjanimin e parregullsive në vazhdimin e kryerjes së detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm në Bashkinë Gjirokastrë, z. K. K. Kështu nga përmbajtja e aktit të konstatimit të mbajtur nga grupi i punës i Komisionerit për Mbikqyrjen e Shërbimit Civil, protokolluar me Nr. 6849Prot., datë 17.09. 2019 rezulton se z. K.K. gjatë kohës që ka mbajtur detyrën e Sekretarit të Përgjithshme në Bashkinë Gjirokastrë, që është pozicioni më i lartë drejtues në marrëdhënien e shërbimit civil, ka qenë njëkohësisht edhe në detyrën e kryetarit të subjektit politik “Lëvizja Socialiste për Integrim” në Gjirokastrë. Ky fakt është i njohur botërisht, pasi është i dokumentuar në pamje televizive, intervista në media, si dhe në korrespondencë zyrtare të subjektit politik në fjalë në lidhje me zgjedhjet e fundit për organet e vetëqeverisjes vendore, duke mos u respektuar në këtë mënyrë detyrimet e ligjit nr. 152/2014, “Për nëpunësin civil”, Neni 37.”*

Nëpërmjet këtij vendimi, Komisioni Disiplinor ka vendosur marrjen e masës disiplinore “*largim nga shërbimi civil*” për nëpunësen civile znj. A.C., për shkak se veprimet dhe mosveprimet e saj kanë sjellë pasoja shumë të rënda. (neni 57, gërma “ç”). Njoftimin e këtij vendimi nëpunëses civile znj. A.C., menjëherë, si dhe të drejtën e znj. A.C., për të ankimuar vendimin, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, brenda 45 (dyzetë e pesë) ditëve nga data e njoftimit.

Në vijim të Vendimit të mësipërm, Kryetari i Bashkisë Gjirokastrë ka miratuar Vendimin nr. 53, datë 22.10.2019, ku përcaktohet përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil të znj. A.C., me detyrë Drejtore e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Bashkinë Gjirokastrë, bazuar në Vendimin nr. 52, Nr. 7999 Prot., datë 18.10.2019, të Komisionit Disiplinor.

Për sa më sipër, mbështetur në dokumentacionin e depozituar pranë KMD-së, rezulton se ankuesja A.C. nuk ka marrë asnjë masë disiplinore përgjatë viteve, që ka punuar pranë Bashkisë Gjirokastrë. Njëkohësisht, Komisioneri ka konstatuar se vlerësimet në punë të ankueses kanë qenë shumë të mira. Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se mbështetur në nenin 60, pika 1, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*” (i ndryshuar) ku parashikohet parimi i përshkallëzimit të masës disiplinore, ankuesja nuk duhet të ishte ndërkohë me masën disiplinore ekstreme të largimit nga shërbimi civil.

Njëkohësisht, Komisioneri gjykon se përgjatë hetimit administrativ të ankesës së znj. A.C., është vënë re tendenca jo pozitive e kryetarit të Bashkisë Gjirokastrë ndaj ankueses, si dhe synimin e tij për ta anashkaluar atë. Komisioneri çmon se në vend të qasjes anashkaluese ndaj saj, duhet të ekzistonte fryma e bashkëpunimit ndërmjet titullarit të ri dhe punonjësve ekzistues të institucionit.

Sipas informacionit të dhënë nga ankuesja, kjo e fundit i ka kundërshtuar gjyqësisht aktet e mësipërme, por kërkesëpadia<sup>6</sup> e saj, është rrëzuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastër.

Në interpretim të pikës 1, të nenit 7 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ku parashikohet: *1. Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim*”, Komisioneri gjykon se znj. A.C. është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë e disfavorizues nga ana e z. F.G., Kryetar i Bashkisë Gjirokastër.

#### **A. Shkaku i mbrojtur.**

Ankuesja A.C. pretendon për diskriminim për shkak të “*bindjes politike*”, nga ana e z. F.G., Kryetar i Bashkisë Gjirokastër.

“*Bindja politike*” është një prej shkaqeve, për të cilat, Ligji Nr.10 221, datë 4.2.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Në lidhje me pretendimin e ankueses për diskriminim për shkak të “*bindjes politike*”, Komisioneri gjykon se “*bindja politike*” konsiderohet si një shkak i mbrojtur, pasi jo vetëm parashikohet si i tillë në bazën ligjore të sipërpërmendur, por edhe sepse ekzistojnë prova të mjaftueshme<sup>7</sup>, që e justifikojnë si të tillë.

#### **B. Lidhja e trajtimit të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë me shkakun e mbrojtur.**

Mbështetur në provat e administruara gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës së sipërpërmendur dhe përkatësisht në referencë të kartës së anëtarësisë nr. 17235, datë 31.08.2016, të lëshuar nga subjekti politik “*Lëvizja Socialiste për Integrim*”, rezulton se ankuesja është

<sup>6</sup> Referuar të dhënave të marra nga web-i i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër rezulton se objekti i kërkesëpadisë është “Shfuqizim vendimi, Rikthim ne pune, Detyrim pagim page”, si dhe vendimi është ende i pazbardhur.

<sup>7</sup> Referuar kartës së anëtarësisë nr. 17235, datë 31.08.2016, të lëshuar nga subjekti politik “*Lëvizja Socialiste për Integrim*”, rezulton se ankuesja është anëtare e kësaj force politike.

anëtare e kësaj force politike. Z. F.G., Kryetar i Bashkisë Gjirokastrë është anëtar i subjektit politik “Partia Socialiste e Shqipërisë”, i cili u shpall fitues në zgjedhjet vendore të vitit 2018.

Ankuesja pretendon se diskriminimi i karakterit politik ndaj saj ka filluar menjëherë pas ardhjes në detyrë të z. F.G., i cili fillimisht i ka dhënë në mënyrë të detyruar lejen vjetore 2019, pa dëshirën e ankueses e në vijim në mungesë të saj, ka ngritur Komisionin Disiplinor për pezullimin dhe largimin e saj nga shërbimi civil, si dhe ka marrë vendimin për largimin e ankueses nga shërbimi civil.

Në rubrikën e sipërpërmendur, Komisioneri konstatoi se ankuesja ishte ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë e disfavorizues nga ana e Kryetarit të Bashkisë Gjirokastrë. Ky trajtim konsistonte në një sërë veprimesh të kryera në titullari i këtij institucioni, të cilat kishin si qëllim anashkalimin në punë të ankueses, duke synuar që proceset e punës, që konsistonin në përfshirjen në mënyrë të domosdoshme të znj. A.C., që ishte Drejtore e Burimeve Njerëzore, të kryheshin në mungesë të saj. Njëkohësisht, Komisioneri konstatoi se fillimi i procedurës disiplinore është kryer gjatë periudhës që, ankuesja ishte me leje vjetore, të cilën e ka kryer në mënyrë të imponuar dhe pa dëshirën e saj, si dhe masa e marrë ndaj saj nuk ka qenë në proporcion me shkeljet e kryera, në kushtet kur vlerësimet e punës së znj. A.C. kanë qenë gjithmonë shumë të mira dhe nuk ka patur asnjë masë disiplinore paraprake, të pashuar.

Përveç sa më sipër, Komisioneri ka analizuar me hollësi disa prej akteve të miratuara nga Kryetari i Bashkisë Gjirokastrë. Duke iu referuar aktit të krijimit të Komisionit Disiplinor, përkatësisht Urdhërit nr. 36, datë 30.08.2019, të Kryetarit të Bashkisë Gjirokastrë, *“Për krijimin e Komisionit disiplinor për pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil në Bashkinë Gjirokastrë”* Komisioneri konstaton se emërtesa e Komisionit Disiplinor është *“Komisioni disiplinor për pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil”*. *“Pezullimi nga shërbimi civil”* dhe *“lirimi nga shërbimi civil”* janë dy nga masat disiplinore që jepen nga Komisioni Disiplinor, në rastet kur ky komision gjykon se shkeljet e konstatuara janë në proporcion me këto masa, ose me masat e tjera disiplinore të parashikuara në nenin 58, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”* (i ndryshuar). Për më sipër emërtesa e këtij Komisioni dëshmon dhe provon se qëllimi i ngritjes së tij ka qenë largimi dhe pezullimi nga shërbimi civil i znj. A.C., dhe për rrjedhojë ka qenë paragjykes. Në referencë të Vendimit nr. 115, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil”* rezulton se emërtesa e përdorur për të është *“Komisioni Disiplinor”* dhe jo *“Komisioni Disiplinor për Pezullimin dhe Largimin nga Shërbimi Civil”*.

E njëjta gjë konstatohet edhe në shkresën nr. 6313 Prot., datë 30.08.2019, e Kryetarit të Bashkisë Gjirokastrë, nëpërmjet së cilës, Komisionit Disiplinor i është bërë kërkesë për fillimin e procedimit disiplinor për znj. A.C., ku edhe është rekomanduar masa disiplinore *“largim nga shërbimi civil”*, si dhe *“pezullim”* i saj. Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se kemi të bëjmë me udhëzim konkret të titullarit të institucionit, për Komisionin Disiplinor, për të vendosur masat e mësipërme disiplinore për znj. A.C..

Në vijim, me Vendimin nr. 37, datë 02.09.2019, e Komisionit Disiplinor, *“Për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pezullimin nga shërbimi civil”* u vendos: *“Fillimin e procedimit disiplinor ndaj*

*nëpunëses civile znj. A.C., me detyrë Drejtor i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Bashkinë Gjirokastrë, për largimin nga shërbimi civil, për shkak se veprimet dhe mosveprimet e saj kanë sjellë pasoja të rënda*". Komisioneri konstaton se Komisioni Disiplinor e ka vendosur masën ende pa shqyrtuar shkeljet e ankueses dhe pasojat që kanë ardhur nga to, fakt ky që dëshmon se Komisioni ka qenë i udhëzuar për të vepruar në këtë mënyrë.

Njëkohësisht, vlen të theksohet fakti se menjëherë pas krijimit të Këshillit të ri Bashkiak është kryer ndryshimi i strukturës organizative të Bashkisë Gjirokastrë. Në bazë të strukturës organike të Bashkisë Gjirokastrë, të miratuar me Urdhërin nr. 485, datë 22.11.2019, e Kryetarit të Bashkisë Gjirokastrë, si dhe Vendimit nr. 116, datë 30.09.2019, të Këshillit Bashkiak, numri i përgjithshëm i punonjësve të Bashkisë Gjirokastrë është 632 punonjës. Në referencë të Vendimit të sipërpërmendur të Kryetarit të Bashkisë Gjirokastrë rezulton se Drejtoria e Burimeve Njerëzore pushon së funksionuari dhe në vend të saj krijohet Njësia e Burimeve Njerëzore, në varësi të drejtpërdrejtë të Sekretarit të Përgjithshëm të Bashkisë Gjirokastrë.

Nga aktet e administruara në cilësinë e provës rezulton se ka patur një seri largimesh nga puna të punonjësve të Bashkisë Gjirokastrë, nga të cilët 20 punonjës kanë dhënë dorëheqjen, 6 punonjës kanë dalë në pension pleqërie dhe 27 punonjës janë larguar nga puna, si pasojë e konstatimit të shkeljeve nga Komisioni Disiplinor, si pasojë e konstatimit të kryerjes së emërimeve pa zbatuar procedurë të rregullt ligjore, si pasojë e emërimeve jashtë profilit etj. Nga 20 punonjës, që kanë dhënë dorëheqjen, 2 prej tyre janë dorëhequr gjatë periudhës kur në pozicionin e Kryetarit të Bashkisë ka qenë znj. Zamira Rami dhe 18 të tjerë në periudhën kur, Bashkia Gjirokastrë filloi të drejtohej nga z. Golemi. Nga 27 punonjës të larguar nga puna, 9 prej tyre janë larguar nga ish-Kryetarja e Bashkisë Gjirokastrë, znj. Z. R. dhe 19 punonjës të tjerë janë larguar nga z. F.G..

Për sa më sipër, parimi i barazisë para ligjit dhe mosdiskriminimit parashikohet nga Kushtetura e Republikës së Shqipërisë, si dhe nga akte të tjera ligjore, duke sanksionuar njëkohësisht edhe zbatimin e tij nga të gjithë shtetasit shqiptarë. Referuar nenit 49, të Kushtetutës së Republikës parashikohet: "*Secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme që e ka zgjedhur ose pranuar vetë. Ai është i lirë të zgjedhë profesionin, vendin e punës, si dhe sistemin e kualifikimit të vet profesional*". Në këtë sens, kjo dispozitë i garanton çdo individ të drejtën për punë.

Njëkohësisht, në referencë të nenit 14, të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut garantohej barazia e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, sikurse edhe në Kartën Social Europiane (të rishikuar) dhe shtojcën e saj përkatësisht në nenin 24, pika 3, gërma d) parashikohet shprehimisht: "*....Nuk do të përbëjnë arsye të vlefshme për përfundimin e punësimit....d) raca, ngjyra, gjinia, gjendja familjare përgjegjësitë familjare, shtatëzania, besimi fetar, opinion politik, prejardhja kombëtare ose origjina sociale*".

Referuar vendimit të Gjykatës Europiane të Drejtësisë<sup>8</sup>, për çështjen *Redfearn kundër Mbretërisë së Bashkuar* (2012), duke u mbështetur në parimin e tij të nenit 11, të KEDNJ-së, që partitë politike janë thelbësore për funksionimin e duhur të demokracisë, Gjykata konsideron: “*Duke pasur parasysh rëndësinë e demokracisë në sistemin e Konventave, Gjykata konsideron se në mungesë të masave mbrojtëse gjyqësore një sistem juridik i cili lejon largimin nga puna vetëm për shkak të anëtarësimit të punonjësve në një parti politike mbart me vete mundësinë e abuzimit*” (paragrafi 55).

Në nenin 5, të ligjit nr.152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, (i ndryshuar) parashikohet: “*Administrimi i shërbimit civil udhëhiqet nga ligji dhe bazohet në parimin e shanseve të barabarta, mosdiskriminimit, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paanësisë politike, si dhe garanton qëndrueshmërinë në detyrë të nëpunësit civil dhe vazhdimësinë e shërbimit civil.*”

Parashikimi i mësipërm është hartuar në të njëjtën frymë me parashikimet ligjore të Ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i cili rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, si dhe përcakton shkaqet, në bazë të së cilave ndaj një individi mund të ketë diskriminim. Nëpërmjet parashikimit të nenit 12, të ligjit të sipërpërmendur ndalohet diskriminimi, në lidhje me të drejtën për punësim, për shkaqet e parashikuara në nenin 1 të këtij ligji. Neni 12, pika 1, gërma c) i këtij ligji parashikon shprehimisht: “*1. Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: .....c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës*”.

Referuar nenit 3, pika 1, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, diskriminimi përkufizohet si: “*“Diskriminimi” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.*”

Mbështetur në pikën 6, të nenit 3, të ligjit të sipërpërmendur parashikohet shprehimisht: “*“Udhëzim për të diskriminuar” është një udhëzim ose kërkesë, bazuar në marrëdhënie hierarkike, për të diskriminuar një ose më shumë persona, në bazë të shkaqeve të përmendura në nenin 1 të këtij ligji.*”

---

<sup>8</sup> Redfearn v The United Kingdom: ECHR 6 Nov 2012

Në këtë kontekst, Komsioneri gjykon se znj. A.C. është diskriminuar për shkak të bindjes politike, nga ana e Kryetarit të Bashkisë Gjirokastrë, në formën e udhëzimit për të diskriminuar.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur nenin 1, neni 3, pika 6, nenin 7, pika 1, nenet 12 - 14, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 10-11, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”,

### **V E N D O S I:**

1. Konstatimin e diskriminimit të znj. A.C., për shkak të bindjes politike, nga z. F.G., Kryetar i Bashkisë Gjirokastrë, në formën e udhëzimit për të diskriminuar.
2. Në referencë të pikës 1 të këtij Vendimi, të merren masat e nevojshme nga Bashkia Gjirokastrë, për rikthimin në punë të ankueses, në një pozicion analog me pozicionin e mëparshëm të punës, që ajo ka mbajtur pranë këtij institucioni.
3. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijëni.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Robert GAJDA**

**KOMISIONERI**

Fusha – punësim  
Shkak – bindja politike